



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:085914
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05765263

C.nr.1301/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit E.H. nga Komuna e D., të cilin e përfaqëson F.B., avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E..”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro, në seancën e datës 30.05.2024 mori ndërsa me datën 31.05.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit E.H. nga Komuna e D., e parashtruar me datë 05.05.2021, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E..”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar av. F.B. me datë 05.05.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E..”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro.

Gjykata, me datën 30.05.2024 ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk kanë prezantuar asnjëra palë në procedurë, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova përkatësisht nga fletëkthesat e kthyer gjykatës, ku shihet qartë se pala paditëse përkatësisht i autorizuari i tij ftesën për seancën e datës 30.05.2024 e ka pranuar me datën 13.05.2024, por që në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, po ashtu në seancë nuk ka prezantuar pala e paditur.

Sipas nenit 409 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit”*. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezulton

se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 409 par.1, 387 par.1 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1301/21, me datë 31.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.